

Raporti epidemiologjik javor për Ethet e Nilit Perëndimor në Maqedoni në vitin 2026 (deri më 18 gusht 2026)

Ky raport javor epidemiologjik ka për qëllim të japë një përmbledhje të shkurtër të të dhënave epidemiologjike për Ethet e Nilit Perëndimor, rastet e raportuara dhe reagimin e autoriteteve të shëndetit publik në Maqedoni në vitin 2026. Të dhënat e prezantuara në këtë raport janë fituar nga raportimet për raste të infeksionit me WNV te njerëzit, të dërguara në ISHP nga ana e mjekëve (infektologëve), anketat epidemiologjike të përgatitura nga epidemiologët e QShP-ve kompetente dhe nga raportimet e laboratorëve që bëjnë testimin e mostrave për këtë sëmundje. Departamenti i epidemiologjisë së sëmundjeve ngjithëse pranë ISHP-së ndërmerr procedurë për verifikimin dhe klasifikimin dhe i heton të gjitha rastet e raportuara brenda 24 orëve, përmes komunikimit me epidemiologët nga QShP-të, mjekët që i trajtojnë të sëmurët dhe pacientët, me qëllim që të identifikohet vendi i mundshëm i ekspozimit, karakteristikat e sëmundjes dhe faktorët e rrezikut. Përveç kësaj, gjendja shëndetësore/rezultati i rasteve të spitalizuara përditësohet çdo ditë.

Në vitin 2026, deri më 18.08.2026, në Maqedoni janë regjistruar gjithsej 38 raste të Etheve të Nilit Perëndimor.

- Nga rastet e regjistruara, sipas përkufizimit të rastit, 36 konsiderohen si të konfirmuara, ndërsa dy si raste të mundshme.
- Sipas vendbanimit të të sëmurëve - 37 raste janë nga Shkupi, ndërsa një nga Velesi.
- Janë regjistruar 37 raste autoktone dhe një rast me histori udhëtimi në Greqi, por periudha e inkubacionit e mbulon edhe qëndrimin në Maqedoni.
- Nga rastet e regjistruara (38) 28 janë meshkuj, ndërsa 10 janë femra.
- Sa i përket shpërndarjes sipas moshës pjesa më e madhe janë persona që i përkasin grupmoshës mbi 60 vjet – 33, katër janë persona të grupmoshës 50-59 vjet, ndërsa një person është i moshës 20-29 vjet. Mosha mesatare është 67,3 vjet (SD $\pm$ 11,2 vjet; min 25, max 83).

Grafiku 1. Shpërndarja e rasteve me WNV sipas gjinisë dhe moshës, Maqedoni, 2026 deri më 18.08.2026

- Të gjitha rastet e regjistruara në vitin 2026 janë te persona të cilët është regjistruar sëmundje neuroinvazive (encefalit dhe/ose meningjit) dhe të gjithë kanë qenë të hospitalizuar, 37 në KU për Sëmundje Infektive dhe Gjendje Febrile dhe një në spitalin "Acibadem Sistina".
- Fillimi i simptomave te pjesa më e madhe e të sëmurëve – 24, është regjistruar në muajin korrik. Te 11 raste fillimi i simptomave është në muajin gusht, dy në muajin qershor, ndërsa te një rast në muajin maj.
- Gjatë vitit 2026 deri më 18.08.2026 janë regjistruar 4 raste të vdekjes te pacientët me sëmundje neuroinvazive nga WNV. Bëhet fjalë për persona të gjinisë mashkullore të moshës nga 62-83 vjet, nga Shkupi, të cilët kanë qenë të hospitalizuar në KUSIGjF. Te tre persona të vdekur janë regjistruar komorbiditete. Diagnoza është konfirmuar me ekzaminim serologjik të lëngut cerebro-spinal (likvor).

Gjatë javës së kaluar (12-18.08.2026) janë raportuar 12 raste të reja. Janë regjistruar 3 raste të reja të vdekjes.

Më 11.08.2026, QShP Shkup raportoi epidemi të Etheve të Nilit Perëndimor në komunat Kisella Voda, Gazi Baba, Aerodrom dhe Butel.

Grafiku 2 i prezanton rastet e raportuara të Etheve të Nilit Perëndimor sipas javës së shfaqjes së simptomave, në vitin 2026, krahasuar me tre vitet e mëparshme (2023-2025) dhe mesataren. Te rasti i parë i diagnostikuar me infeksion WNV në vitin 2026 fillimi i raportuar i simptomave është më 12 maj të vitit 2026 (java e 20/2026).

Grafiku 2. Numri i rasteve të raportuara të WNV sipas javës së shfaqjes së simptomave, Maqedoni, 2023, 2024, 2025, mesatarja 2011-2025, 2026 deri më 18.08.2026

Interpretimi epidemiologjik: Të dhënat tregojnë për një rritje të numrit të rasteve të regjistruara gjatë muajit korrik dhe fillimit të muajit gusht të vitit 2026, me një përqendrim të theksuar hapësinor në rajonin e Shkupit. Numri më i madh i rasteve është regjistruar në komunën e Kisella Vodës, sidomos në vendbanimin Draçevë, si dhe në komunën e Gazi Babës (me përqendrim në zonat rurale). Rritja e regjistruar e numrit të rasteve dhe përqendrimi i tyre hapësinor janë tregues të një transmetimi të intensifikuar lokal të WNV-së në zonat e prekura.

Tabela 2 e prezanton shpërndarjen gjeografike të rasteve të regjistruara me infeksion të diagnostikuar në laborator me WNV në nivel të **komunës së mundshme të ekspozimit**. Vendi i mundshëm i ekspozimit përfaqëson një indikator indirekt për qarkullimin e mundshëm lokal të WNV-së dhe nuk duhet të interpretohet si vend i konfirmuar i infeksionit.

Tabela 2. Rastet e raportuara të infeksionit me WNV sipas komunës së mundshme të ekspozimit, Maqedoni, 2026, deri më 18.08.2026 (n=38)

Rajoni	Njësia	Komuna e mundshme e ekspozimit	Numri i rasteve	I/100.000
i Shkupit	Qyteti i Shkupit	Kisella Vodë	12	19,4
		Gazi Babë	8	11,5
		Aerodrom	3	3,9
		Butel	2	5,3
	Komunat në rrethinën e Qytetit të Shkupit	Ilinden	3	17,2
		Zelenikovë	1	29,8
		Petrovec	2	21,9
		Haračinë	1	7,9
		Studenica	2	9,1
		Sopishte	2	29,8
i Vardarit	Veles	Veles	1	2,1
i Pelagonisë	Dollnen	Dollnen	1	7,6
Gjithsej			38	2,1

**Sipas të dhënave nga anketat epidemiologjike, periudha e inkubacionit dhe qëndrimi në një komunë të caktuar mund të dallojë nga vendbanimi i personit të sëmurë.*

MASAT SHËNDETËSORE PUBLIKE TË MBËSHTETURA NGA ISHP, 2026

1. Edukimi i popullatës për metodat e transmetimit të shkaktarit dhe masat për mbrojtje personale

- Për këtë qëllim, ISHP ka përgatitur material informativ-edukativ për sëmundjet që transmetohen nga vektorët (përfshirë këtu edhe Ethet e Nilit Perëndimor) me mënyrat e parandalimit të sëmundjeve, si dhe materiale me masa për mbrojtje nga mushkonjat.
- Materialet në fjalë u janë dorëzuar institucioneve kompetente. Është e nevojshme që materiali edukativ të vendoset në uebfaqen e ISHP-së dhe 10 QShP-ve, si dhe QShP-të t'ua dërgojnë atë agjencive turistike me qëllim informimin e udhëtarëve që udhëtojnë drejt rajoneve endemike për sëmundjen.

2. Ngritje e vetëdijes te punonjësit shëndetësorë për WNV dhe mbikëqyrje e përforcuar.

- Është e nevojshme që QShP-të t'i njoftojnë mjekët amë, neurologët, pediatrit dhe infektologët nga institucionet shëndetësore në vend për shfaqjen e kësaj sëmundjeje me qëllim ngritjen e vetëdijes për shfaqjen e mundshme të sëmundjes dhe përfshirjen në diagnozën diferenciale.
- Rekomandohet testim laboratorik për WNV te rastet e dyshimta me formë neuroinvazive (siç janë rastet me encefalit, meningjit aseptik, paralizë akute flakcide, ethe me etiologji të papërcaktuar).
- Komunikim me laboratorët që kryejnë testim për Ethet e Nilit Perëndimor në nivel ditor (mbikëqyrje aktive).
- Hulumtimi i të gjitha rasteve të raportuara me qëllim që të përcaktohet vendi i mundshëm i ekspozimit, faktorët e rrezikut dhe rëndësia e sëmundjes.
- Komunikim me spitalet me qëllim që gjendja shëndetësore e rasteve të spitalizuara të përditësohet çdo ditë.
- Komunikim me Institutin e Transfuzionit të Gjakut me qëllim zbatimin e masave të targetuara për sigurinë e gjakut.

3. Komunikimi me publikun dhe institucionet kompetente.

- Informim i rregullt i të gjitha institucioneve kompetente për gjendjen me sëmundjen nga ana e ISHP-së.
- Raport epidemiologjik periodik/javor për Ethet e Nilit Perëndimor i përgatitur nga ISHP dhe publikimi i tij në uebfaqe.
- Komunikim me institucionet ndërkombëtare - ECDC (raportim në EpiPulse).

4. Kryerja e planifikuar e **dezinsektimit parandalues (sipas elaboratit) – dezinfektim larvicid dhe adulticid nga ana e komunave, por edhe dezinfektim sipas indikacioneve**

epidemiologjike (larvicid dhe adulticid) sipas rasteve të regjistruara që është në kompetencë të Qendrave të Shëndetit Publik në territorin që ato e mbulojnë.

- ISHP raporton për procesin e dezinfektimit parandalues të zbatuar nga njësitë e vetëqeverisjes lokale përmes të dhënave të dorëzuara nga 10 QShP-të dhe i raporton institucioneve kompetente për llojin e aktivitetit të zbatuar, mjetin e përdorur, periudhën kur është zbatuar aktiviteti dhe operatorin që e ka kryer aktivitetin.

Parandalimi i sëmundjeve që transmetohen përmes mushkonjave:

1. Masat e drejtuara ndaj mjedisit jetësor (zvogëlimi i popullatës së mushkonjave dhe qëndrimin të tyre në hapësirën jetësore të njerëzve).
 - ✓ Parandaloni shumimin e mushkonjave në mjedisin tuaj:
 - Mos lini enë të hapura me ujë – pjata saksish, fuçi, kanta, mjete lundruese dhe goma të vjetra nëpër oborre në të cilat mund të mblihet uji i shiut.
 - Pastroni rregullisht ulluqet e çatisë për të mundësuar rrjedhjen e ujit.
 - Mirëmbani të pastra pishinat për larje, pishinat dekorative, shatërvanet.
 - Mos krijoni pellgje nëpër oborre.
 - Mirëmbani rregullisht terrenin pranë kanaleve ujore dhe rreth sipërfaqeve të tjera ujore.
 - ✓ Zvogëloni mundësinë për të qenë të ekspozuar ndaj pickimeve të mushkonjave:
 - Vendosni rrjeta mbrojtëse në dyert dhe dritaret e shtëpisë.
 - Shmangni daljen dhe qëndrimin jashtë në agim apo në muzg, kur mushkonjat janë më aktive. Bëni kujdes të veçantë gjatë ujitjes së sipërfaqeve të gjelbra, kopshteve dhe kryerjes së punëve të kopshtarisë që zakonisht praktikohen në këtë periudhë të ditës.
 - Nëse në kushte shtëpiake mbahen shpendë shtëpiakë dhe/ose zogj si kafshë shtëpiake, të kihet kujdes për kushtet higjienike ku ata qëndrojnë, sipas mundësisë vendbanimet e tyre të jenë të mbrojtura me rrjeta, të mirëmbahen të pastra dhe me kohë të ndërrohet uji në enët e tyre të pijes për ta parandaluar shumimin e mushkonjave.
2. Masa për mbrojtje personale nga ickimet nga mushkonjat.
 - ✓ Vishni rroba të përshtatshme, më së miri me ngjyra të çelëta, që do të lënë sa më pak pjesë të zbuluara të trupit (mëngë të gjata, pantallona, çorape, kapele...).
 - ✓ Përdorni mjete mbrojtëse (repelentë) në formë losioni, stiku, spraji ose kremi për lëkurën dhe rrobat, të cilat i largojnë mushkonjat.
 - ✓ Repelentët nuk duhet të vendosen në prerje, plagë të hapura, nën rroba, rreth syve dhe gojës. Te fëmijët e vegjël, përdorimi duhet të jetë sipas udhëzimit të prodhuesit konkret.
 - ✓ Udhëtarët që udhëtojnë në vende apo rajone ku janë regjistruar sëmundje që transmetohen nga mushkonjat, detyrimisht të përdorin repelentë gjatë qëndrimit, ndërsa dritaret dhe shtretërit për fjetje të jenë të mbyllur me rrjeta mbrojtëse, të impregnuara me insekticid adekuat.
 - ✓ Nëse shfaqen simptoma të sëmundjes, menjëherë të kërkohet ndihmë mjekësore dhe të njoftohet mjeku për qëndrimin e fundit në rajone endemike për sëmundje që transmetohen nga mushkonjat. Me shfaqjen e simptomave, sidomos te personat me simptoma neurologjike,

paraqitja me kohë të mjeiku mundëson vlerësim diagnostikues në kohë, trajtim të duhur dhe përcjellje të pacientit.

PËRFUNDIM

Ethet e Nilit Perëndimor për herë të parë në Maqedoni janë regjistruar në vitin 2011. Në periudhën nga viti 2011 deri në fund të vitit 2025 janë regjistruar gjithsej 54 raste të konfirmuara në laborator. Për të njëjtën periudhë janë regjistruar pesë raste të vdekjes të ndërlidhura me këtë sëmundje. Në vitin 2026 është regjistruar një rritje e konsiderueshme në lidhje me numrin e përgjithshëm të rasteve të regjistruara në periudhën 2011–2025, 38 nga 92 raste gjithsej të regjistruara (41,3%) nga viti 2011 deri më sot janë regjistruar vetëm në vitin 2026.

Në vitin 2026 në Maqedoni regjistrohet një rritje e konsiderueshme e numrit të rasteve të WNV-së në krahasim me vitet e mëparshme. Rastet janë të përqendruara kryesisht në rajonin e Shkupit, me numrin më të madh të rasteve në komunat Kisella Voda dhe Gazi Baba. Shpërndarja kohore tregon intensifikim të transmetimit gjatë muajve korrik dhe fillimit të gushtit. Përqendrimi hapësinor dhe kohor i rasteve, së bashku me epideminë e raportuar në komunat Kisella Voda, Gazi Baba, Aerodrom dhe Butel, tregojnë për qarkullim aktiv lokal të WNV-së dhe nevojën për mbikëqyrje të vazhdueshme dhe të përforcuar epidemiologjike dhe masa për kontrollin e vektorëve.

Mbikëqyrja epidemiologjike e sëmundjes, zbatimi sistematik dhe i hershëm i programeve për kontrollin e mushkonjave dhe masat për mbrojtje personale nga pickimet e mushkonjave konsiderohen si masat më adekuate për kontrollin e Etheve të Nilit Perëndimor. Meqenëse qarkullimi i virusit dhe shpërndarja e tij gjeografike (dmth. zonat ku janë regjistruar raste humane) nuk mund të parashikohen, inkurajohet ndërmarrja e masave për mbrojtje personale nga mushkonjat, gjatë gjithë periudhës së aktivitetit të mushkonjave.

Materiali edukativ - informativ i përgatitur nga ISHP:

<https://www.iph.mk/mk/news/index/1783>

<https://www.iph.mk/mk/news/index/1762>

Sipas informacioneve të fundit të disponueshme për Ethet e Nilit Perëndimor nga **Qendra Evropiane për Parandalimin dhe Kontrollin e Sëmundjeve (ECDC)**, nga fillimi i sezonit të transmetimit në vitin 2026, **deri më 13 gusht**, janë identifikuar 77 rajone të prekura nga virusi i Etheve të Nilit Perëndimor (WNV) në nëntë shtete të Evropës. Këto rajone gjenden në Itali (40), Greqi (13), Rumania (12), Francë (4), Maqedoni (3), Spanjë (2), Gjermani (1), Kosovë (1) dhe Serbi (1). Nëntë shtetet kanë raportuar gjithsej 429 raste autoktone të infeksionit me virusin e Etheve të Nilit Perëndimor. Prej tyre, Italia ka raportuar 224 raste, Greqia 105, Spanja 42, Maqedonia 30¹, Rumania 18, Franca 6, Serbia 2, Gjermania 1 dhe Kosova - një rast.

Hartogrami. Rajonet me qarkullim të Etheve të Nilit Perëndimor në Evropë

Departamenti i epidemiologjisë së sëmundjeve ngjitëse Instituti i Shëndetit Publik

Sipas të dhënave të publikuara nga ECDC më 14 gusht të vitit 2026, Maqedonia ka raportuar 30 raste në kuadër të periudhës së mbuluar nga ai publikim. Sipas të dhënave kombëtare, përfshirë këtu edhe datën 18 gusht të vitit 2026, në vend janë regjistruar 38 raste.